

**KONTRATE SHITBLERJE PASURIJE TE LUAJTESHME
PJESE KUOTASH TE SHOQERISE "UNION"SH.P.K.**

Në Dhomen e Noterise Shkodër, dhe para meje noterit të këtij rrethi, Arben Salim Kopliku, me seli ne rrugen "Dos Bosko", karshi Gjykates se Faktit, Shkoder, sot me daten 27. 5. 1999 (njezet e shtate maj njëmije e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë, ditën e ejte, u paraqiten personalisht palët e poshtëshenuara kontraktuesat:.....

Shitës : 1. **Seit Haki Fani**, dtl. 1952, lind e banues në Shkodër, lagje "Naim Gjylbegu", rruga "Hodo Sokoli", pall. 1264, Shkodër.....

2. **Adem Teofik Vuçini**, dtl. 1953, lind e banues ne Shkoder.....

Blerës: 1. **Mehdi Sait Shabani**, dtl.1957, lind e banues në Shkoder, lagje "SaloHalili", rruga "Manush Alimani", Shkoder.....

2. **Ferdinand Enver Nuha**, dtl. 1960, lind e banues ne Shkoder, lagje "Salo Halili", rruga "Ali Kelmendi", nr. 8, Shkoder.....

Për identitetin e të cilëve u sigurova në bazë të letërnjoftimeve të tyre personale dhe pasi konstatova se i kanë të gjithë aftësite e kërkuara nga ligja, me kërkesë të tyre, i redaktova këtë kontratë shitblerje pasurije të luajtëshme, pjese kuotash, si më poshtë vijon:...

Ne baze te vendimeve nr. 6190 dt. 12. 9. 1994, dhe nr. 6190/1 date 12. 1. 1996, eshte rregjistruar prane Gjykates se rrethit Tirane, Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "Union" sh.p.k. me ortake 1.Mehdi Shabani, 2.Ferdinand Nuha, 3. Seit Haki Fani, dhe 4. Adem Teofik Vuçini, me kohezgjatje mbi 11 vjet, me kapital 100.000 leke, dhe me objekt te veprimtarise: Tregtim me shumice e pakice, import-eksport, te artikujve te ndryshem industriale, ushqimore, elektro-shtepiake, materiale ndertimi, produkte bujqesore dhe blegtorale, prodhim dhe tregtim te bukes, karburanteve me shumice, lendes djegese-vajguri, si dhe prodhimin e artikujve te ndryshem ushqimore, industriale dhe materiale ndertimi, gjithashtu sipermarrje ndertimesh e projektimesh sipas kategorive - Projekttime- Kat. 14 c - Projekttime elektrike; Kat. 12 e - Projektimi i kabinave elektrike te rrjetit shperndares, g- Projektim i Linjave te TU dhe te mesem. Per zbatim- kat. 1- punime dheu, sistemime, taracime terenesh, etj. Kat 3 (Elekt)-(Ndertim)- Ndertime civile dhe ekonomike, Kateg. 8/b - Ndertim ujesjellesa dhe kanalizime. c- Ndertim vepra kullimi, ujitje toke dhe impiante vaditese. Kat. 10: a- Rikonstrusione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash etj. Kat. 11 - Punime karpentierie. Kat. 13-d, -e-g.h. Kat 14/d - mirembajtje dhe zhvillim dekorit ne mjedise urbane.....

Shitesit z.z. 1. Seit Fani, dhe 2. Adem Vuçini, deklarojne se me vullnetin e vet te plote, i shesin z.z. 1. Mehdi Shabani, dhe 2. Ferdinand Nuha, kuotat e veta, secili nga 25 %, te kesaj shoqerie, duke u bere keshtu ortake dhe administratore te vetem te shoqerise "Union", z.z. 1. Mehdi Shabani, dhe 2. Ferdinand Nuha, secili me nga 50 % te kuotave te kapitalit themeltar prej 100.000 leke.....

Shitesi dhe bleresit marrin persiper qe te gjithe te drejtat dhe detyrimet qe mund te rrjedhin nga punimet e kryera nga Shoqeria "Union" sh.p.k. qe nga themelimi i saj, e deri me sot, t'i perballojne te kater palet se bashku.....

(Vijon prapa) /..

Kjo akt u lidh me titull akt shitblerje pasurije te luajteshme, pjese kuotash te kapitalit themeltar, duke kryer dhe në të njëjten kohë, të gjithë veprimet pranë organeve kompetente...


Aktit i bashkelidhen dhe vendimet e sipertreguara te Gjykates se rrethit Tirane.....

Kjo kontratë, pasi u lexue me zë të lartë para palëve kontraktuesa, të cilët, duke u gjetur konform kërkimit dhe vullnetit të tyre të plotë, në prezencen time, e pranuan atë, dhe e nënshkruan si me poshte rezulton:.....

Palët kontraktuesa

Shitës

1. Seit Fani 2. Adem Vuçini



Blerës

1. Mehdi Shabani 2. Ferdinand Nuha



Noter

Arben Salim Kopliku

